

MARS 2026

# BULETINI



## Lansimi i Programit të Monitorimit të Policisë “Llogaridhënia në Praktikë”

Programi “Llogaridhënia në Praktikë”, një iniciativë për monitorimin e performancës së policisë me qëllim forcimin e transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve policore, u lansua më 10 mars 2026, në Qendrën Rajonale të Sigurisë Publike në Mitrovicën e Veriut.

Programi zbatohet nga BIRN Kosova në partneritet me ACDC dhe Internews Kosova, me mbështetjen e Ambasadës së Mbretërisë së Holandës në Kosovë dhe Ambasadës së Zvicrës në Kosovë.

Ngjarja mbledhi përfaqësues të shoqërisë civile, Policisë së Kosovës dhe komunitetit diplomatik, të cilët theksuan rëndësinë e transparencës, bashkëpunimit dhe ndërtimit të besimit ndërmjet institucioneve dhe qytetarëve.

Në kuadër të programit, ekipet multietnike nga BIRN dhe ACDC do të monitorojnë punën e policisë në terren, do të mbledhin të dhëna përmes vëzhgimit të drejtpërdrejtë dhe komunikimit me qytetarët, me qëllim forcimin e dialogut ndërmjet policisë dhe komuniteteve lokale dhe rritjen e llogaridhënies institucionale.





## Mbrojtja e Lumit Ibër – Dita Botërore e Ujit

Me rastin e Ditës Botërore të Ujit, 24 Mars 2026, ACDC organizoi një aktivitet kushtuar mbrojtjes së Lumit Ibër në Mitrovicë. Aktiviteti përfshinte një sesion edukativ me të rinjtë dhe një diskutim mbi sfidat e mbrojtjes së ujit, i ndjekur nga një aksion pastrimi të brigjeve të lumit nën urën kryesore në Mitrovicë.



Gjatë Javës së Ujit, ACDC zhvilloi gjithashtu një fushatë online në mediat sociale që synonte rritjen e ndërgjegjësimit rreth ndotjes në Lumin Ibër dhe inkurajimin e qytetarëve për të marrë pjesë aktive në mbrojtjen e tij. Fushata paraqiti gjetjet kryesore nga terreni nga komunat veriore, duke përfshirë identifikimin e mbi 130 pikave kritike të ndotjes, praninë e deponive të paligjshme, shkarkimin direkt të ujërave të zeza dhe nxjerrjen e zhavorrit përgjatë lumit, së bashku me rekomandime për përmirësimin e mbrojtjes dhe menaxhimin më të përgjegjshëm të burimeve.

Ky aktivitet u zbatua në bashkëpunim me REC – Reconciliation Empowering Communities, në kuadër të programit IWRM-K të Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Qeverisë së Kosovës, i zbatuar nga Skat Consulting Ltd. (Zvicër) në konsorcium me Agjencinë Austriake të Mjedisit (EAA).



## “Farat e Bashkëpunimit” – Këndi i Parë i Gjellbër në Mitrovicën Veriore

Në kuadër të projektit “Farat e Bashkëpunimit”, ACDC, së bashku me të rinj nga komunitete të ndryshme, organizoi këndin e parë të gjellbër në veri të Mitrovicës.

U mbjellën bimë dekorative, pemë me gjellbërim të përgjeshëm dhe lule sezonale, duke përmirësuar hapësirën dhe duke e transformuar atë në një mjedis më të këndshëm dhe funksional për komunitetin.

Aktiviteti u zbatua me mbështetjen e Bashkimit Evropian, në bashkëpunim me CARE Deutschland e.V.



## Punëtori për të Rinj – “Nga Dialogu në Ndryshim”

Më 25 mars, Education Code, në bashkëpunim me ACDC, organizoi një punëtori për të rinjtë në Mitrovica Jugore, duke bashkuar të rinj nga Mitrovica Jugore dhe Veriore.

Përmes dialogut, shkëmbimit të ideve dhe punës së përbashkët, pjesëmarrësit zhvilluan ndërgjegjësimin për mbrojtjen e mjedisit dhe rëndësinë e pjesëmarrjes aktive të komunitetit. Projekti financohet nga BOOST Balkans.



## Deklarata të Përbashkëta të Shoqërisë Civile

Gjatë marsit, ACDC, së bashku me organizatat e shoqërisë civile, lëshuan dy deklarata të përbashkëta. E para i'u referua refuzimit për të marrë pjesë në një proces të konsideruar jo transparent në lidhje me zbatimin e Ligjit për të Huajt dhe Ligjit për Automjetet,

 [SRB](#)

 [ENG](#)

 [ALB](#)

ndërsa e dyta shënoi përvjetorin e dhunës së marsit 2004, duke theksuar rëndësinë e diskursit publik të përgjegjshëm dhe duke bazuar narrativat në fakte të vërtetuara.

 [SRB](#)

 [ENG](#)

 [ALB](#)

### ACDC në Media

Gjatë marsit, përfaqësuesit e OJQ ACDC ishin aktiv në media, duke komentuar mbi çështjet aktuale, sociale dhe politike.

Dushan Radaković, Drejtor Ekzekutiv i ACDC – për Kallxo mbi zbatimin e Ligjit për të Huajt dhe Ligjit për Automjetet.

Dushan Radaković – për Kosovo Online mbi kontekstin politik dhe llogaridhënien institucionale.

Dushan Radaković – për Euronews mbi zbatimin praktik të Ligjit për të Huajt.

Dushan Radaković – për Euronews mbi barrierat burokratike dhe sfidat me të cilat përballen qytetarët.

Aleksandar Rapajiq, Menaxher programi në ACDC – për Kosovo Online mbi projektin “Llogaridhënia në Praktikë”.

Aleksandar Rapajiq – për Radio Televizionin e Serbisë mbi zbatimin e Ligjit për të Huajt.

Aleksandar Rapajiq – për Insajder mbi dokumentet e Kosovës dhe aksesueshmërinë e tyre.



[www.acdc-kosovo.org](http://www.acdc-kosovo.org)



[office@acdc-kosovo.org](mailto:office@acdc-kosovo.org)



[www.facebook.com/Ngoacdc](https://www.facebook.com/Ngoacdc)



[www.instagram.com/acdc.kosovo](https://www.instagram.com/acdc.kosovo)



[www.x.com/ngo\\_acdc](https://www.x.com/ngo_acdc)